



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4588/Prot.
1

Tiranë, më 8.7. 2022

URDHËR

Nr. 385, Datë 8.7.2022

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
"MASTER I SHKENCAVE" NË "MJEKËSI VETERINARE" NË KOLEGJIN
UNIVERSITAR "REALD", VLORË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 dhe të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Mjekësi Veterinare", që realizohet me 300 kredite dhe kohëzgjatje normale 5 vite akademike (10 semestra), në gjuhën italiane, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e integruar e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Mjekësi Veterinare", në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, në Kolegjin Universitar "Reald", Vlorë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Mjekësi Veterinare", në Kolegjin Universitar "Reald", Vlorë, fillon në vitin akademik 2022-2023.
3. Kolegji Universitar "Reald", Vlorë të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kolegji Universitar "Reald", Vlorë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Reald”, Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

